

TERRAGUARD PLUS EC

Lenda vepruese: 480 gr/lit Chlorpyrifos + 50 gr/lit Cypermethrin

Tipi i formulimit: Koncentrat i Emulsionueshem (EC)

Eshte insekticid me perbrje fosfororganike dhe piretroide, me spekter te gjere. Karakterizohet nga veprimi i fuqishem kontakti dhe frymemarrje. Si rezultat i permbajtjes se dy lendeve vepruese me mekanizem te ndryshem veprimi (Chlorpyrifos dhe Cypermethrin), shfaqet me nje spekter te gjere veprimi, duke kontrolluar me sukses insekte te grupeve te ndryshme dhe me menyra te ndryshme jetese.

Perdorimi: *Ne peme frutore* per kontrollin e breshkezave te ndryshme, mizes mesdhetare dhe diptereve te tjere, tripseve, morrit te pergjakshem, krimbit te molles, dardhes dhe kumbulles, grerezave, minueseve te gjetheve, me 0.05-0.07 %, ose 50-70 ml preparat/100 L uj. *Ne ullinj dhe agrume* per kontrollin e breshkezave pambukore dhe breshkezave te tjera si *Prays citri*, *Ceroplastes sinensis*, *Aonidiella auranti*, *Planococcus citri*, *Lepidosaphes gloveri*it, krahebardhave (*Trialeurodes*, *Bemisia*), me 0.05-0.07 %, ose 50-70 ml preparat/100 L uj. *Ne vreshta* per kontrollin e tenjave te rrushit, breshkezave, filloxeres, hundegjatit, *Pulvinaria vitis*, me 0.05-0.075 %, ose 50-75 ml preparat/100 L uj. *Ne perime* per kontrollin e krahebardhave, minueseve te gjetheve, krimbave te murrme, krimbave te lakres, tripsit, diptereve (miza e qepes, lakres, karrotes), etj., me 0.075-0.1 %, ose 75-100 ml preparat/100 L uj. *Ne patate* per kontrollin e bubrecit (*L. decemlineata*), tenjes se patates ne fushe dhe gjate magazinimit, me 0.05 %, ose 50 ml preparat/100 L uj. *Ne duhan* per kontrollin e tripsit (*Thrips tabaci*), krahebardhes (*T. Vaporariorum*), me 0.05-0.07 %, ose 50-70 ml preparat/100 L uj. *Ne drithera* per kontrollin e imkave, lemes, zabrusit, mizes hesen, me 0.05-0.07 %. *Ne mizer* per kontrollin e krimbave, me 0.07 %, ose 70 ml preparat/100 L uj. *Ne jonche e foragjere te tjera* per kontrollin e hundegjatit te jonxhes dhe afideve, krimbave te murrme (*Agrotis spp.*), krimbave te lakres (*Pieris.sp.*, *Baratra sp.*), me 0.05-0.07 %, ose 50-70 ml preparat/100L uj. *Per kontrollin e karkalecave:* me 0.075 %, ose 75 ml preparat/100 L uj.

Frazat e rrezikut: H301, H304, H335, H332, H410

Frazat e parandaluese:

P261, P271, P301 + P310, P304 + P340, P312, P391, P403 + P233, P501, EUH401

Regjistrimi: 55-2667-2018 / 10.12.2018

Nr i lotit: 37

Data e prodhimit : 03 2019

Afati i ruajtjes : 2 vjet

Masat parambrojtese:

- Mbajeni ne vende te sigurta dhe te pa arriteshme nga femijet.
- Ruajeni ne vende te thata dhe te fresketa, larg ushqimeve dhe pijeve per njerezit si dhe ushqimeve per blegtorine.
- Evitoni kontaktet e syve dhe lekures me preparatin.
- Evitoni marrjen e preparatit me organet e frymemarrjes gjate pregatitjes se solucionit sperkates dhe gjate sperkatjes.
- Gjate perdorimit te tij mos ha e mos pi uje dhe duhan.
- Gjate punes perdor paisje mbrojtese: kominoshe, doreza, maska, syze.
- Ne perfundim te punes lani paisjet mbrojtese, mjetet sperkatese, duart dhe pjeset e ekspozuara te trupit.
- Beni asgjesimin e ambalazhit sipas rregullave ne fuqi.

Verejtje per perdorimin: Trajtimet fillojne me shfaqjen e infeksioneve te para. Mos sperkatni ne dite me ere. Perzihet me te gjitha fungicidet, me perjashtim te atyre me reaksion alkaline si bordolezi, polisulfuri. Mos kryeni me shume se dy trajtime per sezon. **Ndikimi ne ekosistem:** Eshte helmues per bletet, prandaj evitoni trajtimet ne lulezim ne pemet frutore ose merrni masa qe ato te mos frekuentohen nga bletet te pakten nje jave pas trajtimit. Eshte shume helmues per peshqit. Mos ndotni basenet, pellgjet dhe rruget e ujit me produktin ose ambalazhin bosh. Helmues per insektet e dobishme, kafshet shtepiace, dhe kafshet e egra. **Karenca:** Ne ullinj, agrume, foragjere, grure e mizer 15 dite; perime 21 dite; rrush dhe peme frutore 30 dite. **Magazinimi:** Mbahet ne vende pa lageshti, ne mungese te ndriimit direkt, ne temperaturat 0-35°C.

Prodhues: ZENITH CROPS SCIENCES BULGARIA Ltd.

Importues dhe Distributor :

NTP JONATAN-P Prizren-Kosovo

100 ml